VENDIM
Nr. 118, datë 4.5.2021

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OSSH SH.A., LIDHUR ME RISHIKIMIN E VENDIMIT TË ERE-S NR. 61, DATË 25.2.2021

Në mbështetje të nenit 16, nenit 77, pika 9, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të "Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 232, datë 20.12.2019; të neneve 15, pika 1, dhe 16, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të nenit 92, të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.5.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 67/1 prot., datë 3.5.2021, të përgatitur nga drejtoritë teknike mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 61, datë 25.2.2021,

konstatoi se:

-Shoqëria OSSH sh.a., nëpërmjet shkresës me nr. 7997, datë 21.10.2020, i ka kërkuar ERE-s ndryshimin e kësaj rregullore duke përfshirë në të tipologjitë e konstatimeve në terren, që nuk janë të parashikuara në rregullore, si më poshtë:

- ndërhyrje në sistemin e matjes (makineri e hapur) në bokse kolektive;
- përdorues rrjeti me linjë të dytë në bokse kolektive;
- përdorues rrjeti me neuter të këputur në bokse kolektive;
- përdorues rrjeti me faza të shuntuara në bokse kolektive;
- përdorues të lidhur në rrjet pa kontratë.

- Në zbatim të nenit 77, pika 9, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, ERE përcaktohet si autoriteti përgjegjës për miratimin e "Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike".

- Gjithashtu, shoqëria OSSH sh.a., me shkresën nr. 7997, datë 21.10.2020, i ka kërkuar ERE-s ndryshimin e afateve të parashikuara në nenin 10, të rregullores, si më poshtë:

Afati i lëshimit të faturës, në kushtet kur OSSH sh.a. punon me sistem faturimi me cikël 30-ditor dhe printimi është i tillë, afati lidhur me lëshimin e faturës të jetë brenda 30 ditëve ose ciklit mujor të lexim/faturimit, si dhe njoftimi i furnizuesit të bëhet nga momenti i emetimit të faturës përkatëse, si momenti që zyrtarizon shkeljen.

- ERE, me vendimin nr. 61, date 25.2.2021, ka miratuar fillimin e procedurës për një ndryshim në "Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike", vetëm për një ndryshim në nenin 10, duke përjashtuar pjesën tjetër të kërkesës për ndryshimin në nenin 2 të rregullores, me arsyetimin që ndryshimet e propozuara në nenin 2, të rregullores, nuk argumentohen nga OSSH sh.a. dhe nuk saktësojnë kategoritë e shkaktuesve të dëmit të cilët duhen përfshirë.

- Në vijim, shoqëria OSSH sh.a., me anë të shkresës nr. 3154 prot., datë 31.3.2021, ka kërkuar dhe një herë rishikimin e fillimit të procedurës për një ndryshim në "Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshëm në sistemin e matjes së energjisë elektrike" miratuar me vendimin nr. 61, datë 25.2.2021.

- Për qëllime të analizës së kësaj praktike dhe argumentimeve, sa i përket efekteve reale të supozuara nga OSSH sh.a., reflektuar në kërkesën si më lart, si dhe në përputhje me kërkesat e nenit 92, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 61, datë 25.2.2021, "Për fillimin e procedurës për miratimin e një ndryshimi në 'Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike"', me 30 ditë.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti